

VENDIM
Nr.1455, datë 5.11.2008

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË
NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË
KRYERA NGA BASHKITË HAS E PESHKOPI DHE KOMUNA KOLSH, LEZHË, SI
AUTORITETE KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e bashkive të Hasit e të Peshkopisë dhe të komunës së Kolshit, Lezhë, të përfundojnë, brenda datës 30 nëntor 2008, procedurat e prokurimit, për ndërtimin e tregjeve agroushqimore, me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihen lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Agjencia e Prokurimit Publik, bashkitë Has e Peshkopi dhe komuna Kolsh, Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

Procedura që zhvillohen nga bashkitë Has e Peshkopi dhe komuna Kolsh Lezhë, me fonde të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit:

1. Ndërtim tregu agroushqimor, bashkia Peshkopi, me fond limit 69 304 715 lekë; për vitin 2008, planifikuar 25 milion lekë;

2. Ndërtim tregu agroushqimor, bashkia Has, me fond 63 101 667 lekë; për vitin 2008, planifikuar 20 milionë lekë;

3. Ndërtim tregu agroushqimor, komuna Kolsh, Lezhë, me fond 69 981 676 lekë, për vitin 2008, planifikuar 25 milionë lekë.